

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6544
E premte, 25 shkurt 2022
çmimi 0.40

Bardhyl Mahmuti: Alarmante përpjekja e rishkrimit të historisë së Kosovës në Hagë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RUSIA SULMON UKRAINËN

**RUSIA FILLON PUSHTIMIN E
UKRAINËS, SHTETET
PERËNDIMORE I REAGOJNË**

Bideni: Bota do ta mbajë
Rusinë përgjegjëse për
sulmin

Stoltenbergu: Kërcënim
serioz për sigurinë
euroatlantike


BE-ja paralajmëron
sanksione të ashpra
ndaj Rusisë

Scholz: Ditë e zezë
për Evropën


Macroni: Rusia t'u japë
fund operacioneve
ushtarake

Johnsoni: Jam i tmerruar

Rusia të enjten ka nisur artilerinë ushtarake për ta sulmuar Ukrainën. Në ditën e parë të sulmeve të Rusisë ndaj Ukrainës është raportuar për viktima civile, ushtarë rusë të zënë robër dhe helikopterë të rrëzuar nga forcat ushtarake ukrainase. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, u ka kërkuar bashkëvendësve që ta mbrojnë atdheun e tyre nga agresioni rus. Një veprim i tillë i Rusisë ndaj Ukrainës është dënuar fuqishëm nga bota demokratike, edhe nga Kosova. ShBA-ja, Britania, Gjermania, Franca dhe NATO kanë thënë se nuk do të rrinë duarkryq karshi veprimeve të Rusisë. Në këtë kontekst, presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se bota do ta mbajë Rusinë përgjegjëse për sulmin ndaj Ukrainës



AKTUALE



**PËR 28 DITË NGA KOSOVA
U LARGUAN 42 PUNONJËS
SHËNDETËSORË F. 6**

**PEZULLOHET VOTIMI I
PROJEKTLIGJIT PËR BYRONË
SHTETËRORE F. 6**

**OSMANI TAKON AMBASADORIN
AMERIKAN, FLASIN PËR
ZHVILLIMET NË KOSOVË F. 7**

**REFORMA NË ADMINISTRATËN
PUBLIKE, STANDARD KYÇ PËR
ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BE F. 7**

**NGA 1 MARSIT ITALIA LEHTËSON
MASAT KUNDËR COVIDIT PËR
UDHËTARËT NGA KOSOVA F. 6**

EKONOMI



**PROTESTOJNË PUNËTORËT E
FERRONIKELIT F. 8**

**KRIZA NË UKRAINË MUND T'I
RRISË ÇMIMET NË KOSOVË F. 8**

EKONOMI

**GJILANI RIKTHEHET NË VENDIN
E DYTË, DRENICA NDAN PIKËT
ME PRISHTINËN F. 8**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ohër, kërcënohen pjesëtarët e grupit Lev Tahor

SHKUP, 24 SHKURT - Pjesëtarët e sektit fetar hebre, Lev Tahor, të cilët nga Shkupi janë zhvendosur në qytetin e Ohrit në Maqedoninë e Veriut, kanë reaguar pas presioneve dhe kërcënimeve që kanë marrë nga banorët e fshatit Lakoçerej, ku janë vendosur tani disa ditë. Reagimi i tyre vjen pasi Ministria e Punëve të Brendshme njoftoi se ndaj banores nga Ohri me inicialet V.S ka ngritur padi penale për veprën “përhapje të ksenofobisë dhe nxitjeve raciste”. Sipas MPB-së, kjo banore, përmes një postimi në rrjetin social “Facebook”, kishte bërë thirrje të digjet hoteli ku janë vendosur pjesëtarët e sektit fetar hebre Lev Tahor. “Gjatë bisedës V. S. ka pranuar se ka bërë thirrje, ërmes një statusi në ‘Facebook’, të cilin më pas e kishte fshirë”, thuhet në njoftimin e policisë. Shaje Uingaten, përfaqësuese e sektit fetar Lev Tahor, tha për mediet lokale në Ohër se është

e befasuar nga kërcënimet dhe sjellja e banorëve pasi, siç tha, pjesëtarët e grupit nuk kanë qëllime të këqija dhe se nuk do të qëndrojnë gjatë në Maqedoninë e Veriut. “Maqedonia është një vend i bukur, njerëzit janë të mirë, pavarësisht se individët reagojnë negativisht për praninë tonë. Ne nuk kemi plan të kërkojmë qëndrim të përhershëm. Ne jemi këtu përkohësisht, kemi një leje qëndrimi tremujore. Ne jemi ende në kërkim të një vendi ku të mund të vendosemi dhe të mund të qëndrojmë denjësisht, dhe në fund të bëjmë atë për të cilën jemi këtu, t’i vizitojmë vendet me interes. Kështu, siç po ndodh, ne nuk do të mund të vizitojmë asnjë nga vendet për të cilat kemi ardhur këtu”, deklaroi Shaje Uingaten, përfaqësuese e sektit fetar Lev Tahor. Ajo hodhi poshtë reagimet, por edhe etiketimet e shumta në rrjetet sociale, se pjesëtarët e



këtij grupi janë njerëz të dhunshëm apo se nga vendet e tjera janë dëbuar për shkak të rrezikut që paraqesin për popullatën vendore. “Pse nuk na lejohet të udhëtojmë lirshëm? Pse ka urrejtje ndaj nesh? Ne nuk jemi as spiunë, as terroristë. Njerëzit pa nevojë janë agresivë ndaj nesh... Për momentin nuk kemi vendbanim të përhershëm. Kërkojmë një vend ku do të lejohen t’i praktikojmë të drejtat tona njerëzore dhe fetare, lirinë, siç është shkruar

në Bibël”, ka thënë Shaje Uingaten.

Banorët e fshatit Lakoçerej të Ohrit, ku aktualisht qëndron grupi hebre Lev Tahor, kishin kërkuar nga pronari i hotelit që t’i largojë nga objekti pjesëtarët e këtij grupi, në të kundërtën, ata kanë kërcënuar se do të mbajnë një protestë masive dhe nuk do të lejojnë që fëmijët të shkojnë në shkollë.

Por, policia disa herë kishte bërë thirrje për “tolerancë ndaj këtij grupi që ka leje të rregullt qëndrimi dhe se nuk paraqet

asnjë rrezik për banorët lokalë”.

“Radio Evropa e Lirë” ka raportuar më herët se anëtarët e grupit Lev Tahor janë parë edhe në komunën e Illixhës në Sarajevë gjatë muajit janar. Ata janë larguar nga Bosnjë Hercegovina më 3 shkurt, duke marrë rrugë për Mal të Zi.

Grupi Lev Tahor është akuzuar në të kaluarën për krime kundër fëmijëve, duke përfshirë kidnapime dhe martesat e tyre.

Rreth 200-300 anëtarët e këtij grupi kanë kërkuar me dekada një shtet që do të ishte nikoqir i interpretimit të tyre ultra-ortodokse të Torës. Ata kanë qëndruar edhe në vende të tjera për katër dekada prej themelimit të grupit në Izrael, në fund të viteve 1980. Më 2018 udhëheqësia e grupit Lev Tahor ka kërkuar azil në Iran, ndonëse plani besohet se ka rënë në ujë, pas dëbimit nga ana e autoriteteve irakiane për në Turqi.

EUFOR rrit praninë në Bosnjë Hercegovinë



SARAJEVË, 24 SHKURT - Forca e Bashkimit Evropian në Bosnjë Hercegovinë, e njohur si EUFOR, ka bërë me dije të enjten se do të angazhojë rreth 500 pjesëtarë shtesë në këtë shtet si masë mbrojtëse. Në njoftim EUFOR ka thënë se vendimi është marrë për t’i mbështetur në mënyrë më efikase partnerët në Bosnjë dhe për të siguruar një ambient të sigurt.

“Përkeqësimi i situatës së

sigurisë në nivel ndërkombëtar ka potencial të përhapë jostabilitet në Bosnjë Hercegovinë. Angazhimi i këtyre forcave është masë parandaluese për ta forcuar stabilitetin në Bosnjë përmes pozicionimit të forcave të mjaftueshme”, është thënë në njoftim.

EUFOR është angazhuar në Bosnjë Hercegovinë prej vitit 2004.

Aktualisht ka rreth 3 500

pjesëtarë, prej të cilëve rreth 600 janë të angazhuar në këtë shtet.

Personeli shtesë do të nisët nga Austria, Bullgaria, Rumania dhe Sllovakia.

Megjithatë, EUFOR ka thënë se vlerëson që aktualisht nuk sheh ndonjë kërcënim që do ta kërkonte mbështetjen e forcës. Njoftimi i EUFOR-it vjen në ditën kur Moska ka marrë vendim për pushtim të Ukrainës.

Talebanët u kërkojnë grave të mbulohen, goftë edhe me batanije

Kabul, 24 shkurt - Policia fetare e talebanëve u ka thënë grave që punojnë në qeverinë e talebanëve të mbulohen, në të kundërtën mund t’i humbin vendet e punës. Ministria për Promovim të Virtytit dhe Parandalim të Vesit ka thënë më 22 shkurt se gratë nuk duhet të shkojnë në punë nëse nuk janë të mbuluara në mënyrën e duhur. Ende nuk është bërë e qartë pse kjo deklaratë është lëshuar në këtë kohë.

Shumica e grave në Afganistan kanë gjithmonë kokat e mbuluara kur dalin në publik. Ato mund të vendosin “tjetër lloj hixhabi. Varet nga ato, por ato duhet të mbulohen si duhet... apo edhe të vendosin batanije”, ka thënë zëdhënësi i ministrisë për agjencinë e lajmeve AFP. Shumica e grave kanë humbur vendet e punës në institucionet qeveritare prej kur talebanët kanë marrë pushtetin në gusht të vitit të kaluar.

Liderët talebanë kanë pretenduar se gratë do të lejohen të kthehen në punë kur të krijohen ato që i konsiderojnë kushtet e duhura, siç është ndarja e hapësirave brenda zyrës. Prej marrjes së pushtetit nga talebanët, zyrtarë të Perëndimit dhe aktivistë, bashkë me disa brenda Afganistanit, kanë shprehur shqetësime për të drejtat e grave nën rregullin ekstrem konservator të udhëheqësisë së talebanëve.



Bardhyl Mahmuti: Alarmante përperjekja e rishkrimit të historisë së Kosovës në Hagë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ish-përfaqësuesi politik i UÇK-së, aktualisht udhëheqës i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur", Bardhyl Mahmuti, ka thënë se është alarmante përperjekja e rishkrimit të historisë së Kosovës në Hagë. "Kambana rreh për atë që ka vesh të dëgjojë. Alarmin që japin avokatët, është alarm që është dhënë edhe më parë. Disa muaj para se të arrestoheshin ish-udhëheqësit e UÇK-së, një intelektual i njohur francez, i cili ka shkruar për shqiptarët që nga Ilirët e deri te pavarësia e Kosovës, thekson manipulimet e mëdha që i janë bërë BE-së nga shërbimet sekrete serbe dhe ruse, për të miratuar një strukturë, e cila do të vë në bankë të akuzës luftën çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës", ka thënë Mahmuti në emisionin "RTK Prime". Sipas tij, ajo që po ndodh sot në Hagë nuk ka lidhje vetëm fatin e individëve, por janë bërë mbi 16 muaj që njerëzit padrejtësisht mbahen larg familjeve të tyre, në kushte të këqija, se nuk ka burg të mirë. "Mund të krijohet përshtypja se Haga është në Evropë dhe atje kushtet janë të mira. Ky është një proces tejet i rëndë, se nuk kemi të bëjmë me fatin intelektual, por është e vendosur në bankë të akuzës lufta jonë. Pra, qëllimi është politik edhe i gjithë kësaj strukture sepse, në thelb, ishte pikërisht të dënohet lufta



çlirimtare e Kosovës", ka thënë ai. Gjithashtu, Mahmuti rikujtoi përperjekjet e shumta që pati ai bashkë me udhëheqësit e UÇK-së ta bindin botën se në UÇK ka vlera demokratike për ta çliruar vendin. "Me mund dhe angazhim të madh diplomatik Drejtoria Politike e UÇK-së ka ndërmarë me qindra aktivitete që ta bindim botën se kjo strukturë ka njerëz që kanë vlera demokratike, dhe të cilët po mundohen ta çlirojnë vendin

dhe t'i japin mundësi Kosovës të ndërtojë një shoqëri të hapur demokratike", u shpreh Mahmuti. Elementi tjetër, thotë ai, është se duhet që të jemi më vigjilentë rreth alarmit që bëjnë avokatët e Thaçit, Veselit, e intelektualët e ndryshëm që ia duan të mirën Kosovës. "Sot ta vendosësh luftën çlirimtare të Kosovës në bankën e akuzës dhe duke bërë përgjegjëse UÇK-në për krimet e sajara në laboratorët e

shërbimeve sekrete serbe, qëllimi është veçse politik. Qëllimi është që të ndëshkohet kjo luftë dhe pikërisht të rishkruhet historia e asaj çfarë ka ndodhur në Kosovë në dem të popullit shqiptar, të saj dhe në dem të pavarësisë së Kosovës", ka thënë Mahmuti. Prandaj, ai thotë se shkrimi i historisë që po bëhet para syve tanë duhet të na alarmojë të gjithëve. "Në rend të parë institucionet shtetërore të

Kosovës, që e kanë për obligim të sensibilizohen në maksimum, sepse për këtë punë nuk vlej në inatet personale, por është çështje për interesat jetike të popullit të Kosovës. Është çështje jetike e pavarësisë së Kosovës. Duhet lënë anash divergjencat personale dhe të angazhohen dhe mobilizohen të gjithë si në rrafshin politik, intelektual, juridik e diplomatik që ta fitojmë edhe këtë betejë", ka thënë Bardhyl Mahmuti.

Kapen 83 kilogramë drogë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHKURT - Në Terminalin Doganor të Hanit të Elezit autoritetet ligjzbatuese kanë kapur 83.5 kilogramë drogë, që dyshohet të jetë e llojit heroinë. Sipas kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Ferizajt, Shukri Jashari, deri më tani janë arrestuar shtatë persona. Ai ka thënë se të arrestuarit janë dërguar në mbajtje për 48 orë, ndërkaq dy të tjerë janë ende në kërkim. Jashari ka theksuar se droga u gjet gjatë kontrolleve të doganierëve në një manunë që ishte nisur nga Turqia. Sipas tij,

destinacioni i drogës, që ishte fshehur në disa reflektorë, ishte Prishtina. "Gjatë kontrollit të Doganës së Kosovës është dyshuar se në mjetin transportues, përveç mallrave të ndryshme, kanë qenë edhe 32 reflektorë, ku në to të paketuara kanë qenë nga pesë qese, të dyshuara me substancën e llojit heroinë - gjithsej 160 paketime", ka thënë Jashari në një konferencë për medie. Zyrtarë të Doganës dhe Policisë kanë bërë me dije se aktualisht janë duke u zhvilluar bastisje në pesë lokacione në Prishtinë dhe Pejë dhe se deri më tani kanë sekuestruar mallin që ishte në maunën ku u gjet droga, si dhe dy vetura të tjera.

Haradinaj me tri kërkesa për Osmanin, Kurtin dhe Konjufcën

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka kërkuar që të kthehet projekti i gazsjellësit amerikan Shkup - Prishtinë. Haradinaj përmes

një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" u është drejtuar presidentes, kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit me disa kërkesa, ku në mesin e kërkesave është edhe miratimi i Ligjit për

Donacionin për Ushtrinë e Kosovës. "Pushtetarë të Kosovës: Presidente, kryeministër, kryeparlamentar: 1. Kthejeni projektin e gazsjellësit amerikan Shkup-Prishtinë; 2. Përfundojeni

Strategjinë Nacionale të Sigurisë; 3. Miratojeni Ligjin e Donacioneve për Ushtrinë e Kosovës. Thirrni ndërgjegjes suaj për hir të fëmijëve tanë", ka shkruar Haradinaj.





RUSIA FILLON PUSHTIMIN E UKRAINËS, SHTETET PERËNDIMORE I REAGOJNË

Rusia sulmon Ukrainën

Rusia të enjten ka nisur artilerinë ushtarake për ta sulmuar Ukrainën. Në ditën e parë të sulmeve të Rusisë ndaj Ukrainës është raportuar për viktima civile, ushtarë rusë të zënë robër dhe helikopterë të rrëzuar nga forcat ushtarake ukrainase. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, u ka kërkuar bashkëvendësve që ta mbrojnë atdheun e tyre nga agresioni rus. Një veprim i tillë i Rusisë ndaj Ukrainës është dënuar fuqishëm nga bota demokratike, edhe nga Kosova. ShBA-ja, Britania, Gjermania, Franca dhe NATO kanë thënë se nuk do të rrinë duarkryq karshi veprimeve të Rusisë. Në këtë kontekst, presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se bota do ta mbajë Rusinë përgjegjëse për sulmin ndaj Ukrainës

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHKURT - Rusia ka hedhur raketa në shumë qytete të Ukrainës, përfshirë kryeqytetin Kiev, duke shënjestëruar objektet e mbrojtjes ajrore dhe infrastrukturën ushtarake, pak para agimit të së enjtes, ndërsa zbarkoi ushtarët në bregun jugor të vendit.

Sulmi filloi menjëherë pasi presidenti rus, Vladimir Putin, ka njoftuar në televizion atë që ai e përshkroi si një "operacion

special ushtarak", të cilin ukrainas thonë se është një pushtim në shkallë të plotë të vendit të tyre, i dyti më i madhi në Evropë.

Presidenti rus u shfaq i zemëruar në një fjalim që u transmetua pak para orës 4:00 të mëngjesit sipas kohës së Evropës Qendrore, duke theksuar se nuk mund të toleronte më ato, që ai i quajti kërcënime nga Ukraina. Ai e përfundoi fjalimin e tij duke paralajmëruar fuqitë e jashtme që të mos ndërhyjnë, ndryshe do të shkaktonte "pasoja që ata nuk i kanë parë kurrë".

Presidenti Putin ka thënë se qëllimi i tij ishte "çmilitarizimi dhe denacifikimi i Ukrainës", ndërsa ka theksuar se "do të sjellim në gjykatë ata që kanë kryer shumë krime, përgjegjës për gjakderdhjen e civilëve, duke përfshirë qytetarët rusë".

Putini ka paralajmëruar se nëse ushtarët ukrainas nuk i dorëzojnë armët, do të jenë përgjegjës për gjakderdhjen. Menjëherë pas fjalimit të tij, u dëgjuan shpërthime intensive raketash në qytetin lindor, Kharkiv dhe më pas u dëgjuan shpërthime sporadike në periferi



Tanket ruse në flakë dhe ushtarët e vrarë

të Kievit, nga drejtimi i aeroportit kryesor ndërkombëtar Boryspil dhe aeroportit të tij të dytë, në Zhuliany. "Putini sapo ka nisur një pushtim të plotë të Ukrainës. Qytetet paqësore të Ukrainës janë nën sulm", ka treguar ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, në rrjetet sociale. "Kjo është një luftë agresioni. Ukraina do ta mbrojë veten dhe do të fitojë. Bota mund dhe duhet ta ndalojë Putinin. Tani është koha për të vepruar", ka shkruar ministri Kuleba.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, shpalli ligjin ushtarak, duke u bërë thirrje qytetarëve të mos bëjnë panik, pasi Rusia nisi sulmet ndaj vendit të tij. Ai ka theksuar se të enjten Rusia ka vënë në shënjestër infrastrukturën ushtarake të Ukrainës dhe se shpërthime janë dëgjuar në gjithë vendin.

Më vonë ai shpalli ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Moskën, ndërsa u bëri thirrje të gjithë qytetarëve që janë të gatshëm ta mbrojnë vendin e



Tanket ruse



Helikopterët rus



tyre të paraqiten për t'u armatosur.

Presidenti Zelenskyy ka treguar se ka biseduar në telefon me presidentin amerikan Joe Biden dhe Shtetet e Bashkuara po punojnë për të siguruar mbështetje ndërkombëtare për Ukrainën.

Brenda disa orësh pas sulmeve me raketa, tanket ruse kaluan kufijtë e Ukrainës, nga Rusia, Bjellorusia dhe nga Krimea, gadishulli ukrainas i aneksuar nga Moska në vitin 2014. Zyrtarët ukrainas thanë se forcat amfibe ruse zbarkuan pranë Odesës në bregun e Detit të Zi.

Bideni: Bota do ta mbajë Rusinë përgjegjëse për sulmin



Rrëzohet avioni rus dhe shpërthen në flakë

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët do të vendosin "sanksione të ashpra" ndaj Rusisë, pasi forcat e saj ushtarake kanë nisur sulm në Ukrainë, ka thënë presidenti amerikan Joe Biden, pas shpërthimeve që janë dëgjuar në kryeqytetin ukrainas, Kiev dhe në qytete të tjera.

Bideni ka folur me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskyy dhe e ka njoftuar për hapat që do të marrë Uashingtoni kundër Rusisë, duke përfshirë edhe një takim special të Këshillit të Sigurimit të Bashkuara. "Sot do të takohem me liderë të grupit të shtatë vendeve më të industrializuara (G7) dhe Shtetet e Bashkuara me aleatët e partnerët tanë do të vendosim sanksione të ashpra ndaj Rusisë", ka thënë Bideni përmes një deklarate. Ai ka thënë se Uashingtoni do të vazhdojë të ofrojë mbështetje dhe ndihma për Ukrainën dhe popullin e saj. Bideni ka dënuar veprimet e presidentit rus, Vladimir Putin, i cili ka thënë, në një fjalim televiziv, se ka autorizuar "operacion ushtarak special" në lindje të Ukrainës. "Presidenti Putin ka zgjedhur luftë të paramenduar që do të rezultojë me humbje katastrofike të jetëve të njerëzve dhe vuajtje të tyre", ka thënë Bideni para se të

diskutonte me presidentin ukrainas. "Rusia është përgjegjëse për vdekje dhe shkatërrimet që do të sjellë ky sulm. Bota do ta mbajë Rusinë përgjegjëse".

Stoltenbergu: Kërcënim serioz për sigurinë euroatlantike

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se "e dënon fuqishëm sulmin e pamatur dhe të paprovokuar të Rusisë ndaj Ukrainës, i cili vë në rrezik jetë të panumërta civilësh. Edhe një herë, pavarësisht prej paralajmërimeve tona të përsëritura dhe përpjekjeve të palodhura për t'u angazhuar në diplomaci, Rusia zgjodhi rrugën e agresionit kundër një vendi

sovran dhe të pavarur".

Stoltenberg ka thënë se sulmi është një shkelje e rëndë e ligjit ndërkombëtar dhe një kërcënim serioz për sigurinë euroatlantike, ndërsa i bëri thirrje Rusisë që t'i ndërpresë menjëherë veprimet e saj ushtarake dhe ta respektojë sovranitetin dhe tërësinë tokësore të Ukrainës. "Aleatët e



Helikopteri rus rrëzohet afër Kievit

NATO-s do të takohen për t'i trajtuar pasojat e veprimeve agresive të Rusisë, tha ai, duke nënvizuar se aleatët qëndrojnë me popullin e Ukrainës në këtë kohë të tmerrshme. NATO-ja do të bëjë gjithçka që duhet për t'i mbrojtur të gjithë aleatët", ka pohuar Stoltenbergu.



BE-ja paralajmëron sanksione të ashpra ndaj Rusisë

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka paralajmëruar sanksione të ashpra kundër Rusisë, pas vendimit të presidentit rus, Vladimir Putin, për ta nisur operacionin ushtarak special në Ukrainë. "Me këtë paketë ne do të shënjestrojmë sektorë strategjikë të ekonomisë ruse duke bllokuar qasjen e tyre në teknologji kyçe dhe tregje", ka thënë ajo. "Ne do ta dobësojmë bazën ekonomike të Rusisë dhe kapacitetet për t'u modernizuar".

Shefja e BE-së ka thënë se Bashkimi Evropian është me Ukrainën. "Rusia duhet ta tërheqë ushtrinë dhe ta respektojë plotësisht integritetin territorial të Ukrainës".

Scholz: Ditë e zezë për Evropën

Kancelari gjerman Olaf Ssholz ka thënë se sulmi rus në Ukrainë është një shkelje e hapur e ligjit ndërkombëtar. "Nuk ka asnjë

justifikim për të. Gjermania e dënon këtë akt të pamatur të presidentit Putin me fjalët më të ashpra të mundshme. Solidarizohemi me Ukrainën dhe popullin e saj. Rusia duhet të ndalojë menjëherë këtë veprim ushtarak. Në kuadër të G7-s, NATO-s dhe BE-së, ne do të bashkërendohemi nga afër

sot. Kjo është një ditë e tmerrshme për Ukrainën dhe një ditë e zezë për Evropën", ka shkruar kancelari gjerman në rrjetet sociale.

Macroni: Rusia t'u japë fund operacioneve ushtarake

Presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë se dënon me



Kosova dënon sulmin rus ndaj Ukrainës

Kuvendi i Kosovës ka dënuar të enjten sulmin rus ndaj Ukrainës, derisa kryetari i këtij institucioni, Glauk Konjufca, ka thënë se "Kuvendi i Kosovës dhe populli i saj qëndrojnë përkrah popullit të Ukrainës".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se sulmi rus në Ukrainë përbën agresionin e dytë më të madh ushtarak që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Duke diskutuar për këtë situatë, Kurti ka përmendur se të mërkurën, më 23 shkurt, në Kosovë është mbajtur mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare. "Me disa ministra dhe drejtues të institucioneve të sigurisë kemi vlerësuar, diskutuar, analizuar situatën aktuale dhe masat që duhet të ndërmarrim në mënyrë që orientimi ynë evropian dhe euroatlantik të jetë në nivelin, cilësinë dhe intensitetin më të

forcë vendimin e Rusisë për ta filluar luftën në Ukrainë. "Rusia duhet t'i përfundojë menjëherë operacionet e saj ushtarake. Franca solidarizohet me Ukrainën. Ajo qëndron me ukrainasit dhe punon me partnerët dhe aleatët e saj për t'i dhënë fund luftës", ka shkruar Macron në rrjetet sociale.

Johnsoni: Jam i tmerruar

Kryeministri britanik Boris Johnson u shpreh i tmerruar nga ngjarjet e tmerrshme në Ukrainë. "Kam folur me presidentin Zelenskyy për të diskutuar për hapat e ardhshëm. Presidenti Putin zgjodhi rrugën e gjakderdhjes dhe shkatërrimit duke nisur këtë sulm të paprovokuar ndaj Ukrainës. Mbretëria e Bashkuar dhe aleatët tanë do të përgjigjen me vendosmëri", ka shkruar Johnson në llogarinë e vet në "Twitter".



Nga 1 marsi Italia lehtëson masat kundër Covidit për udhëtarët nga Kosova

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Që nga data 1 mars Italia do t'i lehtësojë masat kundër Covidit për të gjithë ata që udhëtojnë jashtë drejt këtij shteti, përfshirë edhe Kosovën.

Ambasada e Kosovës në Itali ka njoftuar se masat e reja lehtësuese do të hyjnë në fuqi më 1 mars dhe do të jenë në fuqi deri më 31 mars. "Me qëllim të rikthimit të normalitetit në vend, Ministria e Shëndetësisë e Italisë ka nënshkruar urdhëresën e re që parashikon

lehtësimin e masave për të gjithë ata që udhëtojnë nga shtetet jashtë BE-së, në të cilën është përfshirë edhe Kosova. Me kusht që të mos shfaqen simptoma të Covid-19, nga data 1 mars 2022 të gjithë ata që udhëtojnë drejt Italisë janë të obliguar të respektojnë dhe paraqesin dokumentet e nevojshme. Masat në fuqi lejojnë hyrjen në Itali, me detyrimin që secili t'i paraqesë dokumentet e mëposhtme: formularin digjital PLF, i cili

duhet të plotësohet në formë digjitale apo të shtypur; Certifikatën e vaksinimit për vaksinim të plotë apo certifikatën e lëshuar nga autoritetet kompetente pas shërimit nga Covid-19, apo vërtetim ekuivalent i lëshuar nga Autoritetet Kompetente Shëndetësore, e vërtetuar nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA); Certifikatat mund të tregohen në format digjital ose kopje e shtypur", ka njoftuar Ambasada e Kosovës në Itali.



Për 28 ditë nga Kosova u larguan 42 punonjës shëndetësorë

Kuadri specialistik mjekësor po vazhdon të ikë nga Kosova për kushte dhe pagë më të mira në vende të ndryshme të botës. Në tryezën me temën "Gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë, kemi apo nuk kemi sistem shëndetësor funksional? Kahja e reformës së nevojshme", të organizuar nga Oda e Mjekëve e Kosovës, është bërë me dije se për 28 ditë janë larguar 42 persona të stafit mjekësor

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ikja e mjekëve për në vendet evropiane është problemi kryesor me të cilin po ballafaqohet shëndetësia në Kosovë dhe motivimi i tyre nuk është vetëm çështja financiare, por janë edhe kushtet e punës dhe mundësitë për shkollim. Në

këtë të fundit shteti duhet të angazhohet që stafi mjekësor të shkojë në shkollim jashtë vendit me kontratë që edhe të kthehen. Kështu u tha në tryezën me temën "Gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë, kemi apo nuk kemi sistem shëndetësor funksional? Kahja e reformës së nevojshme", të organizuar nga Oda e Mjekëve e Kosovës.

Si problematikë kryesore në këtë tryezë u përmend edhe ikja e punëtorëve shëndetësorë, ku për 28 ditë u larguan 42 punonjës shëndetësorë.

Kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës, Pleurat Sejdiu, ka thënë se kjo tryezë ka për qëllim gjetjen e problemeve që po ndodhin në shëndetësi. Ai ka thënë se duhet të fillohet të mendohet edhe për specializantët. Sejdiu ka

falënderuar ministrin e Shëndetësisë, Rifat Latifi, për praninë, duke thënë se me ardhjen e tij në krye të shëndetësisë së Kosovës, pritet që gjendja në këtë sektor të përmirësohet.

Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka potencuar rëndësinë e zhvillimit të shëndetësisë në të gjitha nivelet, ku në rend të parë dhe synim kryesor është pacienti. Ai ka thënë se të gjithë së bashku mund të bëjnë shumë për sistemin shëndetësor, duke përfshirë edhe zhvillimet teknologjike.

Ministri Latifi ka thënë se edukimi profesional i mjekëve, specializantëve, infermierëve

dhe të tjerëve është shtylla kryesore e të ecurit përpara, pra e zhvillimit të shëndetësisë. "Të gjithë duhet të mendojmë si ministër, kryeministër, si mjekë, shkencëtarë, në mënyrë që shëndetësia në vend të zhvillohet dhe të jetë në nivelin e duhur, ashtu siç dëshirojmë jo vetëm ne, por edhe qytetarët e Kosovës", ka thënë ai.

Ministri Latifi edhe një herë ka shprehur nevojën se të gjithë së bashku duhet të diskutojnë për zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale, organizimin e punës dhe për shumë gjëra të tjera me rëndësi për përmirësimin e shëndetësisë në Kosovë.



Pezullohet votimi i Projektligjit për Byronë Shtetërore

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Votimi i Projektligjit për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme është shtyrë për një afat të pacaktuar deri në përgjigjen nga Komisioni i Venecias. Pas kërkesave të opozitës, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka bërë me dije se do t'i drejtohet për opinion këtij Komisioni. Me 79 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët kanë votuar për pezullimin e

afateve të parapara me rregulloren e Kuvendit lidhur me këtë projektligj, deri në një njoftim të radhës. "Në linjë të zotimit të kryetarit votimi në parim për këtë projektligj do të ndodhë pas kthimit të përgjigjes ose opinionit nga komisioni i Venedikut", ka thënë nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Byroja për Verifikim të Pasurisë nuk do të ketë kompetencë që ta konfiskojë pasurinë e

pajustificueshme, pasi ajo nuk është as prokurori, e as gjykatë.

Pas deklaratave nga opozita se Byrosë për Verifikim të Pasurisë po i jepet më shumë kompetencë se që duhet, pasi do ta drejtojë vetëm një person i cili zgjidhet me një votim të thjeshtë në Kuvend, Kurti ka deklaruar se kjo byro nuk do të konfiskojë pasuri. Ai ka theksuar se konfiskimi bëhet vetëm nga gjykata. "Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme bëhet



vetëm nga gjykata. Gjykata e garanton procedurën profesionale dhe respektimin e palëve në procedurë të cilën e njohin

Kushtetuta dhe ligjet në fuqi. Pra, konfiskimin nuk e bën byroja, por gjykata", ka thënë Kurti gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës.

Tri raste të vdekjes dhe 189 raste me Covid në Kosovë

Prishtinë, 24 shkurt (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se prej 2 628 testimeve, 189 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar tri raste të vdekjes.

Të enjten janë shënuar 247

qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 219 749. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 2 996.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 912 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 810 642 doza të vaksinës. Deri më sot 814 749 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 96 873 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Reforma në administratën publike, standard kyç për anëtarësimin e Kosovës në BE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHKURT - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në konferencën e organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike që për temë kishte reformën e administratës publike. Kurti ka thënë se reforma në administratën publike ka rol qendror në programin e tij qeverisës "për shkak të rolit të rëndësishëm që ka për lidhjen organike në demokraci ndërmjet shtetit, qytetarëve, shoqërisë civile dhe sektorit privat, si dhe për shkak se aftësia e shtetit për të arritur reforma në administratën publike është standardi kyç për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian", u shpreh kreu i qeverisë.

Një nga përbërësit kryesorë për një zhvillim të qëndrueshëm, sipas kryeministrit Kurti, është një administratë publike efektive, llogaridhënëse dhe e orientuar drejt qytetarëve, derisa theksoi se administrata jonë publike

përballet me sfida nga më të ndryshmet. "Dua të theksoj që pavarësisht avancimit ligjor që kemi bërë si vend në sektorin e administratës publike, kemi trashëguar probleme të shumta. Adresimi i tyre, zgjidhja e tyre, përpos vullnetit dhe kohës, kërkon edhe një qasje transformativë. Por, besimi i lartë qytetar, që është edhe përgjegjësi e lartë, njëkohësisht paraqet mundësi të mirë. Me qeverisjen tonë nevoja e kamotshme për reformë të administratës publike, përveç pritje dhe kërkesë e qytetarëve, është synim dhe veprim ynë", ka thënë Kurti.

Pasi renditi disa nga proceset kryesore në kuadër të reformës së administratës publike në të cilat qeveria është duke punuar, si ajo e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030, rishikimi i Ligjit për Zyratë Publike dhe procesi i zvogëlimit të barrës administrative, kryeministri Kurti ka theksuar se kjo konferencë sot është një mundësi e mirë për diskutimin e ideve për reformat që synojnë t'i bëjnë.



Osmani takon ambasadorin amerikan, flasin për zhvillimet në Kosovë

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim të rregullt ambasadorin amerikan Jeffrey Hovenier. Në takim është diskutuar për zhvillimet në vend, rajon dhe më gjerë pas agresionit ushtarak të Federatës Ruse ndaj Ukrainës. Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova ka qëndrime të njëjta me aleatët tanë duke dënuar ashpër agresionin ushtarak rus

dhe njohjen ilegale nga Federata Ruse të "pavarësisë" së të ashtuquajturave Republika Popullore të Luhanskut dhe Donetskut. Ajo, gjithashtu, ka potencuar se Kosova qëndron me popullin e Ukrainës përderisa po përballet me agresionin rus dhe se vendi ynë do ta vazhdojë koordinimin e plotë me aleatët në mënyrë që të parandalohet destabilizimi i rajonit tonë.

Policia e Kosovës mbyll disa "rrugë ilegale" për parandalimin e kontrabandës

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ministri i Punëve të Brendshme në Kosovë, Xhelal Sveçla, ka njoftuar të enjten se Policia e Kosovës ka nisur të mbyllë disa rrugë që, siç ka thënë ai, shfrytëzohen për kontrabandë. Ai ka thënë se mbyllja e këtyre rrugëve

është tentim për ta parandaluar dhe luftuar krimin dhe të gjitha format e kontrabandës në zonat kufitare që lidhin Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Në tetor të vitit të kaluar Policia e Kosovës pati

zhvilluar një aksion të gjerë kundër kontrabandës në rajonin e Prishtinës, Pejës, Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut. Policia e Kosovës pati thënë se në atë aksion u sekuestruan mallra "të kontrabanduara në vlerë prej qindra mijëra eurosh".



Kriza në Ukrainë mund t'i rrisë çmimet në Kosovë



PRISHTINË, 24 SHKURT - Kriza midis Rusisë dhe Ukrainës mund t'i rrisë edhe më shumë çmimet e produkteve në tregun e Kosovës, thonë ekspertët të ekonomisë. Perëndimi, përfshirë Bashkimin Evropian dhe ShBA-në, ka nisur tashmë vendosjen e sanksioneve kundër shtetit rus, i cili, më 21 shkurt, ka marrë vendim për njohjen e rajoneve separatiste të Ukrainës, Donjeck dhe Luhansk, si shtete të pavarura. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka urdhëruar dërgimin e trupave ruse atje. Perëndimi i ka cilësuar këto veprime si shkelje mbi sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe ka paralajmëruar "sanksione shkatërruese" nëse Rusia nis pushtim në shkallë të gjerë. Ekspertët e ekonomisë thonë se kriza, me doemos, do të ketë ndikim në tregje, marrë parasysh faktin se Rusia është furnizuesja më e madhe e Evropës me gaz natyror. Në

përgjigje të krizës apo sanksioneve nga Perëndimi, ka frikë se Rusia mund të zvogëlojë apo ndërpresë furnizimin e Evropës me gaz. Gjermania, Italia dhe Franca janë disa nga shtetet e Bashkimit Evropian që varen shumë nga gazi rus, e nga të cilat Kosova importon shumë. Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Nagip Skënderi, thotë se përshkallëzimi i krizës mund ta rrisë koston e energjisë dhe të derivateve të naftës. Rritja e çmimeve të tyre, pastaj, mund të ketë efekt zinxhiror. "Rritja e çmimit të energjisë dhe derivateve të naftës reflekton në ngritje të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të tjera", thotë Skënderi për "Radion Evropa e Lirë". Një ditë pas vendimit të presidentit rus për njohjen e pavarësisë së rajoneve separatiste të Ukrainës, çmimet e naftës dhe të gazit janë rritur me shpejtësi. Të martën çmimi i naftës së

papërpunuar Brent, e cila është pikë ndërkombëtare e referimit, ka arritur në 99.38 dollarë për fuçi, apo në nivelin më të lartë në shtatë vjet. Çmimet e naftës kanë qenë në trend të rritjes edhe më herët për shkak të, siç është raportuar në mediet ndërkombëtare, tensioneve gjeopolitike dhe pabarazisë në rritje midis ofertës dhe kërkesës. Në tre katër muajt e fundit në Kosovë çmimet e naftës dhe të benzinës janë rritur për 20 deri në 25 centë. Për më tepër, qytetarët e Kosovës janë përballur muajt e fundit me çmime më të shtrenjta edhe të produkteve bazë, si: buka, mishi, qumështi, djathi, vaji, vezët, pemët, perimet e të tjera. Për një kategori të qytetarëve është rritur edhe çmimi i energjisë elektrike. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni në janar të këtij viti ka arritur në 7.1 për qind, krahasuar me 0.2

për qind sa ka qenë në janar të 2021-shit. Për rritjen janë fajësuar çmimet më të larta të gazit në botë dhe çrregullimet që ka shkaktuar në furnizime pandemia e koronavirusit. Eksperti i ekonomisë në Kosovë, Musa Limani, thotë se rritja e mëtejshme e çmimeve do të jetë e pashmangshme, nëse konflikti midis Rusisë dhe Ukrainës merr përmasa më të mëdha. Sipas tij, konflikti do t'i tensionojë tregjet në Evropë dhe Kosova, në mënyrë indirekte, do të ndikohet. "Një krizë që paraqitet në vendet e Evropës, reflektohet në ekonominë e Kosovës, pasi pjesën më të madhe të të mirave materiale Kosova e importon nga shtetet e Evropës. Kosova nuk ka transaksione ekonomike me Rusinë dhe Ukrainën dhe nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë, por në mënyrë të tërthortë mund të ndikojë", thotë Limani.

Shkëmbimet tregtare Kosovë - Ukrainë

Në tregun e Kosovës ka produkte nga Ukraina, por jo në sasi të mëdha. Sipas Doganave të Kosovës, vlera e mallrave ukrainase, të importuara në vitin 2020, ka qenë rreth 19 milionë euro, ndërsa vitin e kaluar kjo vlerë gati është dyfishuar: mbi 36 milionë euro.

Miell, kafe, çaj, vaj, tekstil, qeramikë janë disa nga produktet e importuara vitin e kaluar nga Ukraina në Kosovë.

Mallrat që Kosova ka eksportuar në Ukrainë vitin e kaluar kanë kapur vlerën e mbi 22 mijë eurove, ndërsa në vitin 2020 mbi 70 mijë euro.

Ekspertët e ekonomisë thonë se tregtarët në Kosovë kanë mundësi t'i zëvendësojnë produktet nga Ukraina me ato të shteteve të tjera. "Me këto produkte tregtarët duhet të furnizohen nga shtetet e tjera dhe kostoja të jetë më e ulët dhe mos të reflektojë në shportën e konsumatorit", thotë Skënderi.

Sipas të dhënave të Doganave, Kosova është skajshmërisht e varur nga importi.

Mbi 4.6 miliardë euro ka qenë vlera e produkteve të importuara në Kosovë në vitin 2021, ndërsa shumë më pak, 712 milionë euro, ka qenë vlera e eksporteve. Kosova importon kryesisht nga Bashkimi Evropian dhe nga vendet nënshkruese të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA): Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnjë Hercegovina, Mali i Zi dhe Moldavia.

Protestojnë punëtorët e Ferronikelit

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Punëtorët e kompanisë Ferronikeli kanë protestuar të enjten para institucioneve të Kosovës, ndërsa një pjesë e tyre kanë tentuar të hyjnë në oborrin e Kuvendit të Kosovës. Protesta u mbajt nën organizimin e Sindikatës së

Pavarur të Punëtorëve të Ferronikelit. Kërkesë kryesore e punëtorëve ishte që të ndërmerren veprime konkrete nga ana e qeverisë për kthimin në prodhim dhe kthimin e punëtorëve të Ferronikelit në punë, të cilët po vuajnë pasoja të rënda ekonomike nga kriza e gjatë.

"Pesë muaj pas ndërprerjes së prodhimit në fabrikë, qeveria në vazhdimësi ka neglizhuar kërkesat tona të natyrës urgjente, përkundër thirrjeve e lutjeve për ndihmë dhe dy protestave paqësore me numër të lartë pjesëmarrësish", kanë deklaruar punëtorët.



Pse Rusia nuk mund ta rindërtojë Bashkimin Sovjetik



Nga Lesia DUBENKO
"Kyiv Post"

Ultimatumi i Rusisë ndaj SHBA-së dhe NATO-s së bashku me grumbullimin e trupave të saj ushtarake në kufirin ukrainas, kanë rindezur debatin nëse Rusia dëshiron që të rindërtojë Bashkimin Sovjetik. Si një provë për këtë, shumë gazetarë dhe analistë politikë, përmendin deklaratën e presidentit rus Vladimir Putin në vitin 2005, se shembja e Bashkimit Sovjetik ishte katastrofa më e madhe gjeopolitike e shekullit XX, por edhe esenë e tij të vitit të kaluar, mbi të ashtuquajturin unitet historik midis kombeve ukrainase dhe ruse. Edhe pse ky arsyetim duket sikur është i vërtetuar, realiteti na tregon një histori krejtësishtjetër. Bashkimi Sovjetik ishte dikur një shtet komunist në zhvillim. I mbështetur tek ideologjia marksiste-leniniste, ai ishte një shtet totalitar socialist me kufij të mbyllur, me një ekonomi të planifikuar, dhe ku prona ishte publike. Përveç kundërshtimit të saj të ashpër ndaj lirisë së fjalës, Rusia moderne ka pak të përbashkëta me atë strukturë historike. Sot federata ruse është një shtet shumë kapitalist, me grupime oligarkike të fuqishme, dhe me një korrupsion endemik. Nuk janë më të fortit, por më të pasurit ata që mbijetojnë në Rusinë moderne, duke instaluar tualete prej ari në vilat e tyre, dhe duke udhëtuar shumë shpesh

drejt Monakos, diçka që aparatçikët sovjetikë vetëm mund ta ëndërronin. Me kalimin e viteve, ekonomia ruse është integruar disi me atë të Perëndimit, duke u shtrirë përtej eksportit të lëndëve të para. Bankat ruse, si "Sberbank" në pronësi të shtetit, operojnë edhe jashtë vendit, duke përfshirë vendet anëtare të Bashkimit Evropian si Hungaria dhe Republika Çeke. Ndërkohë, korporatat e saj si "Yandex" kanë hapur degë në mbarë botën, madje edhe në SHBA. Njëra prej tyre është kompania e etiketimit të të dhënave "Toloka" me bazë në SHBA. Ndonëse 75 për qind e të anketuarve të një sondazhi të vitit 2020, e kujtojnë vazhdimisht me nostalgji epokën sovjetike, vetëm 28 për qind e tyre janë të gatshëm që ta rinisin atë rrugë. Rusëve të sotëm u pëlqen të udhëtojnë, të kenë blogjet e tyre në internet, dhe të blejnë marka të shtrenjta perëndimore, duke mos punuar në një fabrikë për pak para. Po ashtu ata janë mësuar të jetojnë në një ekonomi të çuditshme laissez-faire (liberale), ku je i mirëpritur të ndërtosh biznesin tënd për sa kohë që "ndan fitimet" me "njerëzit e duhur", duke përfutur gjithashtu nga nismat sociale të Kremlinit. A është vërtet e mundur të rindërtohet Bashkimi Sovjetik i dikurshëm në një mjedis të tillë? Dhe kush do ta paguajë faturën e krijimit të një unioni me një ekonomi të përbashkët dhe axhendë socialiste, sidomos nëse Rusia nis një luftë të gjithanshme kundër Ukrainës?

Oligarkët nuk janë
tamam për këtë punë.

Edhe pse disa media dhe analistë perëndimorë kanë krijuar një atmosferë mistike rreth metodave të Vladimir Putinit për të administruar vendin e tij, realiteti është ndoshta shumë më pak i fshehtë. Sipas disa analistëve rusë, Putin është arbitri që di t'i luajë letrat e tij në një mënyrë të tillë, që figurat kryesore të elitës në vend të mbeten të kënaqura. Detyrimi i tyre për të financuar një projekt socialist, do të kërkonte përdorimin e një forcebrutale, shpronësimit e pronarëve privatë të fabrikave, dhe shumë veprime të tjera jopopullore në aspektin social, që mund të ishin të mundura në Perandorinë Ruse në stanjacion ekonomik dhe të shkatërruar nga lufta në vitin 1917, por jo në Rusi në bashkëkohore me oreksin e saj për të gjitha gjërat elegante të kësaj bote. Kina, e cila është gjithashtu një vend izolacionist, jo-miqësor ndaj NATO-s, por edhe një shtet shumë kapitalist, që përfiton nga krahu i saj i lirë i punës (një fakt ironik duke pasur parasysh drejtohet nga një parti komuniste), ka pak arsye për ta financuar një projekt të tillë. Përplasja e saj me SHBA-në, nisi kryesisht për shkak të armiqësisë së ish-presidentit amerikan Donald Trump ndaj Kinës. Megjithëse marrëdhëniet Kinë-SHBA janë përkeqësuar që kur Pekini e mbështeti ultimatumin e fundit të Rusisë ndaj Ukrainës, të dyja vendet vazhdojnë të jenë jashtëzakonisht të varura nga njëra-tjetra. Në vitin 2020, shkëmbimet tregtare

arritën në 559.2 miliardë dollarë. Kjo do të thotë se Pekini dhe Uashingtoni do të vazhdojnë të bashkëpunojnë, pavarësisht nga dallimet e tyre, duke arritur marrëveshje mes tyre atëherë kur do të jetë e nevojshme. Përveç kësaj, Kina ka ambicet e veta, të cilat kërkojnë investime të mëdha, siç është nisma e Rrugës dhe Brezit. Atëherë pse është kaq shumë popullor koncepti i ringjalljes së Bashkimit Sovjetik? Unë supozoj se kjo gjë ndodh për disa arsye. Së pari, sepse Kremlini po e ndërton me sukses këtë iluzion, për të tërhequr disa nga votuesit e të tij që e romantizojnë të kaluarën, teksa jetojnë në një Rusi bashkëkohore shumë të ndryshme. Ai është një mjet shpërçendruar si dhe një metodë shumë e fuqishme, që synon të mjegullojë qëllimet dhe ambicet reale, të cilën gjykoar nga mënyra se si komunikon me homologët e tij perëndimorë, Putin duket se e pëlqen shumë. Së dyti, termik "sovjetik" është një markë e lehtë për t'u kuptuar jashtë vendit. Brezi i vjetër i kujton ende kohët kur BRSS ishte një antonim i lirisë, ndërsa të rinjtë e konsumojnë atë në seriale televizive, video lojëra dhe blogje udhëtimesh, duke treguar "xhevahiret" e epokëssovjetike. Për pasojë, gazetarët dhe analistët perëndimorë, shumë prej të cilëve u mungon dëshira për të analizuar rajonin, të kaluarën e tij të çuditshme dhe të vështirë, si dhe mentalitetin vetë-kundërshtues, zgjedhin klishe me të cilat lexuesit dhe shikuesit e tij lidhen menjëherë. Në një që rindërtimi i Bashkimit Sovjetik është ndoshta i pamundur

si në nivelin ideologjik ashtu edhe ekonomik, kjo nuk do të thotë se Rusia nuk po synon që të rikthejë ndikimin e saj global dhe veçanërisht rajonal. Duke pasur parasysh madhësinë, fuqinë ushtarake, potencialin bërthamor dhe axhendëkonservatore, Rusia do të jetë gjithmonë një shtet i etur për pushtet. Ajo do të përdorë mjete hibride të shoqëruara me sjellje ushtarake të çuditshme. Grumbullimi i ushtrisë ruse në kufi, i ka shkakuar që tani dëme të mëdha ekonominë ukrainase, gjë që e bën këtë të fundit një objektiv më të lehtë për të qenë ekonomik e ndërvarur. Edhe pse që nga viti 2014, Kievi e ka zgjeruar tregtinë e tij me Bashkimin Evropian, Ukraina bën ende biznes me Rusinë, dhe qarkullimi tregtar midis 2 vendeve është në rritje. Për më tepër, sapo të nisë punën gazsjellësi "Nord Stream 2" – fatkeqësisht, shanset që kjo të ndodhë janë të mëdha, dhe jo vetëm sepse Gjermania është një aleate e rreme e Ukrainës – ky vend do të shndërrohej në një mjet shtesë për ndikimin hibrid, i cili mund ta ndihmojë Putinin të rivendosë ato që ai mendon se janë sferat ruse të ndikimit, dhe të krijojë një mjedis të sigurt për synimet e saj aktuale politike dhe ekonomike. Ky do të ishte një opsion shumë më i mirë, sesa krijimi i një perandorie socialiste në një botë kapitaliste. Por edhe nëse e gjitha kjo është e gabuar, dhe Kremlini dhe Putin personalisht duan që të rindërtojnë Bashkimin Sovjetik, lajmi i mirë është se fati i tij është praktikisht i paracaktuar: ai do të shembet, ashtu siç ndodhi edhe me paraardhësin e tij, Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gjilani rikthehet në vendin e dytë, Drenica ndan pikët me Prishtinën

Skuadra e Gjilanit, me tri pikët e marra nga ndeshja kundër Dukagjinit (2-1), është rikthyer në pozitën e dytë në Superligë. Në ndeshjen e zhvilluar në Skenderaj, Drenica ndau pikët me Prishtinën (0-0). Lidere pas javës së 21-të është skuadra e Ballkanit me 42 pikë



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 24 SHKURT - Me dy ndeshjet e zhvilluara të enjten ka përfunduar java e 21-të në Superligën e Kosovës në futboll. Gjilani e ka mposhtur Dukagjinin me rezultat 2-1, kurse Drenica ka luajtur baras me Prishtinën (0-0). Ndeshja e zhvilluar në Gjilan solli tre gola të shënuara nga penalltia, dy herë realizuan vendasit dhe një herë mysafirët. Gjilani shënoi në pjesën e parë nga penalltia me anë të Gerhard Prognit për rezultatin 1-0, kurse në minutat shtesë të kësaj pjese nga loja u përjashtua portieri Enea Koliçi, i cili luajti me dorë jashtë zonës së rreptësisë. Dukagjini barazoi në pjesën e dytë me golin e Mentor Zhdrellës nga penalltia, kurse vendasit shënuan edhe një tjetër gol nga pika e bardhë për rezultatin final 2-1. Realizues ishte Progni.

Pas kësaj xhiroje, Gjilani renditet në vendin e dytë me 42 pikë, po aq sa ka edhe Ballkani që renditet në vendin e parë. Në anën tjetër skuadra nga Klina pozicionohet e nënta me 18 pikë. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua të enjten, Drenica ndau pikët me Prishtinën, duke luajtur baras 0-0. Pas këtij barazimi kryeqytetasit mbeten në pozitën e gjashtë me 25 pikë, ndërsa Drenica zë vendin e pestë me 28 pikë. Ndërsa të mërkurën janë zhvilluar tri ndeshje. Drita u është rikthyer fitoreve në Superligë pasi e ka mposhtur Malishevën me rezultat 1-2. Simonovski dhe Fazliu ishin realizues për mysafirët, ndërsa për vendasit shënoi Marc-Olivier. Fitores iu gëzua edhe Ballkani që e mposhti Ulpianën (3-0), kurse golat i shënuan Edvin Kuç, Blend Baftiu dhe Mevlan Zeka. Ndërkohë Llapi e mposhti Feronikelin (4-2). Për klubin e drejtuar nga Tahir

Batatina shënues ishin Alef Firmino, Maliqi, Amadu dhe Bianor Neto, ndërsa për mysafirët realizuan Seferi dhe Kiqina.

SUPERLIGA - Java 21

Gjilani - Dukagjini	2-1
Drenica - Prishtina	0-0
Malisheva - Drita	1-2
Ballkani - Ulpiana	3-0
Llapi - Feronikeli	4-2

Tabela

1. Ballkani	42 pikë
2. Gjilani	42
3. Drita	41
4. Llapi	36
5. Drenica	28
6. Prishtina	25
7. Malisheva	23
8. Ulpiana	19
9. Dukagjini	18
10. Feronikeli	11

SHKURT

Të dielën dalin në shitje biletat e ndeshjes Kosovë - Norvegji

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se të dielën më 27 shkurt nga ora 15:00 do të dalin në shitje biletat për ndeshjen Kosovë - Norvegji. Biletat do të shiten para palestrës "Minatori" në Mitrovicë dhe kushtojnë 3 euro. Për shkak të masave kundër Covidit të shpallura nga Qeveria e Kosovës, numri i tifozëve do të jetë i kufizuar. Biletat mund t'i blejnë vetëm personat të cilët janë të vaksinuar me dy doza. Në palestër duhet të respektohen masat kundër Covidit, si mbajtja e maskës dhe distanca sociale. Takimi Kosovë - Norvegji zhvillohet të dielën nga ora 19:00 në "Minatori" të Mitrovicës në kuadër të rrethit të parë parakualifikues për Eurobasket 2025.

Kompania turke 'E-kent' në Kosovë për digjitalizimin e sistemit të biletarisë

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, me bashkëpunëtorë, ka zhvilluar të enjten takim me përfaqësuesit e kompanisë turke "E-kent", Atil Aykar dhe Ozgur Çelikoglu. Kjo kompani është lidere në sistemin e biletarisë dhe mirëmban sistemin e ndeshjeve të Superligës turke në futboll dhe basketboll. Në fakt, FFK-ja në kuadër të strategjisë së digjitalizimit është duke e zhvilluar sistemin e biletarisë me këtë kompani për ndeshjet e BKT Superligës, projekt ky i sponsorizuar nga BKT. Përfaqësuesit e kompanisë turke po qëndrojnë në Kosovë për ta kryer fazën e fizibilitetit të stadiumeve.

UEFA ia heq Rosisë organizimin e finales në Ligën e Kampionëve

Finalja e Ligës së Kampionëve këtë sezon nuk do të mbahet në Rusi. Në fakt, ndeshja më e madhe e vitit për klube është paraparë të zhvillohet në St. Petersburg. Por, pas sulmit ushtarak të sotëm të Rosisë në Ukrainë, gjithçka do të ndryshojë sa i përket finales në Ligën e Kampionëve. UEFA e ka thirrur për të premtën një mbledhje të jashtëzakonshme të Komitetit Ekzekutiv dhe ajo do të mbahet në Nyon të Zvicrës, duke filluar nga ora 10:00. Ende nuk dihet se ku do të zhvendoset finalja e Ligës së Kampionëve. Në këtë takim pritet të merren edhe vendime të tjera pas situatës së rëndë të krijuar në Ukrainë.

Bashkimi ndan rrugët me trajnerin Paviq

Prizren, 24 shkurt - KB Bashkimi ka njoftuar përmes rrjeteve sociale se është ndarë me trajnerin e deritashëm. Skuadrës prizrenase nuk po i ecin punët shumë mirë në Art Motion Superligë, ku aktualisht gjendet në vendin e

gjashtë në tabelë. Andaj prizrenasit e panë të nevojshme dhe të domosdoshme që të bëhen ndryshime në krye të shtabit teknik. Bashkimi ka njoftuar se shumë shpejt do ta zgjedhë trajnerin e ri. "Trajneri i

deritashëm i skuadrës sonë, Branimir Paviq, nuk do të jetë më pjesë e KB Bashkimit. Bashkëpunimi me kroatin është ndërprerë pas dorëheqjes së tij, duke besuar që ekipi ka nevojë për rifreskim. Ne e falënderojmë

trajnerin Paviq për kontributin e tij dhe i urojmë suksese në vazhdim të karrierës. Së shpejti do t'ju njoftojmë me emrin e trajnerit të ri", thuhet në njoftimin e skuadrës së Bashkimit.



Nadali më i mirë në histori, Medvedevi synon ta zbresë Djokoviqin nga fronti

MADRID, 24 SHKURT - Sezoni 2022 në tenis ka nisur me mjaft surpriza. Tenisti spanjoll Rafael Nadal vijon të jetë i pamposhtur këtë vit. Pas triumfit në Australian Open, ai e nisi me fitore

edhe turneun e Akapulko, duke e çuar në 12 numrin e fitoreve radhazi këtë vit (0 humbje). Ky është fillimsezon i më i mirë në karrierën e Nadalit, që në vitin 2014 ishte ndalur në 11

fitore. "Jam në formë të mirë dhe për mua ka rëndësi që t'i mbyll ndeshjet sa më shpejt të jetë e mundur, për ta ruajtur energjinë", u shpreh Nadal. Në këtë turne luan edhe rusi Daniil Medvedev,

numri 2 në botë. Në rast triumfi në Akapulko ai do të jetë numri 1 në botë, duke zbritur nga fronti Novak Djokoviq. Serbi aktualisht luan në turneun e Dubait, i kualifikuar në çerekfinale.



Pronarit të Chelseat, Roman Abramovich, i ndalohet të jetojë në Britani pas lidhjeve me regjimin e Putinit

LONDËR, 24 SHKURT - Pronarit rus të Chelseat, Roman Abramovich, thuhet se i është ndaluar në mënyrë efektive të jetojë në Britani të Madhe. Miliarderi nuk është parë në shtëpinë e klubit të tij në jugperëndim të Londrës, "Stamford Bridge", për muajt të tërë. Ai tërhoqi aplikimin e tij për një vizë investitori britanik të nivelit 1 në vitin 2018, pas raportimeve të vonesave në aplikimin e tij pas kritikave ndaj oligarkëve rusë pas helmimeve në Salisbury. Sipas mediumit britanik "The Sun", burime të larta të sigurisë tani thonë se nuk ka gjasa që 55-vjeçari të lejohet të jetojë përsëri në Britani. Zyrtarët e imigracionit thuhet se janë nën udhëzime për ta bërë të pamundur që Abramovich, i cili zotëron një rezidencë 125 milionë funtesh pranë Pallatit Kensington, të vendoset në Mbretërinë e Bashkuar. Rasti i tij thuhet se po trajtohet nga 'Njësia e Rasteve Speciale' të Home Office. Kjo vjen pasi Abramovich u emërua nga deputetët të martën si njëri nga 35 oligarkët e identifikuar nga kreu i opozitës ruse Alexei Navalny si njëri nga 'mundësuesit kryesorë' të 'kleptokracisë' të drejtuar nga presidenti i vendit, Vladimir Putin. Ai mohon me forcë se është afër Kremlinit ose ka bërë ndonjë gjë që do ta meritonte vendosjen e sanksioneve kundër tij - pasi



Britania synonte të vendoste sanksione ndaj Ruisë në mes të tensioneve në rritje me Ukrainën. Në vitin 2018 Abramovich u bë shtetas izraelit, duke e lejuar atë të hynte në Britani deri në gjashtë muaj. Ai përdori pasaportën e tij izraelite tetorin e kaluar për të bërë një udhëtim të shkurtër në Londër. Megjithatë, një burim i lartë i ka thënë "The Sun" se çdo përpjekje e oligarkut për të aplikuar për një vizë të përhershme 'pothuajse me siguri do të refuzohej'. Abramovich ka një pasuri të vlerësuar prej 8.4 miliardë funtesh. Përveç pronave të shumta, ai zotëron një seri super-jahtesh, duke përfshirë Solaris prej 450

milionë funtesh, i cili ka një sistem zbulimi të raketave. Miliarderi nuk ka mbajtur kurrë nënshtetësinë e Mbretërisë së Bashkuar dhe i ka fituar paratë e tij duke shitur pasuri të blera nga shteti kur Bashkimi Sovjetik u shpërbë. Ai mbërriti në Chelsea në vitin 2003 dhe e transformoi skuadrën nga ekipi i mesit të tabelës në një gjigant të Ligës Premierë dhe Ligës së Kampionëve me ndihmën e Jose Mourinhos. Pjesa më e madhe e pasurisë së Abramovichit në Mbretërinë e Bashkuar gjendet në Evraz, një gjigant çeliku dhe minierash i listuar në bursën e Londrës.

Wijnaldumi: PSG-ja është si Liverpooli

PARIS, 24 SHKURT - Vetëm pak javë më parë është folur për pakënaqësi dhe një largim të tijin të mundshëm nga Parisi. Georginio Wijnaldum duket se ka ndryshuar mendim, ose më mirë, ka shpjeguar "pakënaqësinë" e tij për revistën e PSG-së. "Fakti është se kur kam bërë intervistën në të cilën kam thënë se gjërat nuk po shkonin siç shprejoja, isha i zhgënjyer. Nuk po gjeja shumë hapësira dhe mendoj se kushdo, kur qëndron në stol, nuk është i lumtur" ka thënë holandezi. "Megjithatë, mediet i kanë interpretuar fjalët e mia sikur unë doja të largohesha. Por nuk është kështu". Holandezi ka folur më pas për momentin e skuadrës, së cilës i kërkohet të



fitojë në Francë dhe Evropë: "Duhet kohë për të formuar një skuadër të mirë, duhet të njihemi dhe të kalojmë pak kohë bashkë. Duke parë burimet që ka klubi, të gjithë presin që të fitojmë gjithçka, por nuk

funksionon kështu. Këtë e them nga përvoja personale. Kur jam bërë pjesë e Liverpoolit, ajo ishte një skuadër në ndërtim dhe kjo vlen në njëfarë mënyre edhe për PSG-në", ka shtuar mesfushori holandez.

SHKURT

Pas sulmeve nga Rusia, pezullohet kampionati në Ukrainë

Mëngjesin e së enjtes së 24 shkurtit, pak orë pasi kishin filluar bombardimet ruse në disa nga qytetet kryesore të Ukrainës, erdhi edhe lajmi zyrtar: kampionati i futbollit ukrainas është pezulluar. Ka qenë vetë federata ukrainase që ka dhënë njoftimin në faqen zyrtare: "Për shkak të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Ukrainë, kampionati i futbollit është pezulluar". Premierë Liga ukrainase duhej të startonte më 25 shkurt, por në këtë situatë të vështirë që ka mbërthyer vendin është e vështirë të mendohet për futboll.

Lucescu: Nuk do të largohem nga Kievi, s'jam frikacak

Mircea Lucescu, trajneri i Dymano Kyivit, ka komentuar situatën që po ndodh në Ukrainë. Ushtria ruse është futur në këtë vend dhe gjithçka është në kaos. "Të gjitha aktivitetet sportive në Ukrainë janë pezulluar për 30 ditë. Nuk do të largohem nga Kievi për t'u kthyer në Rumania, nuk jam frikacak. Shpresoj që këta njerëz të mëdhenj pa tru ta ndalin këtë luftë. Nuk e kam menduar kurrë se kjo do të ishte e mundur", ka thënë Lucescu.

Futbollisti rus del hapur kundër luftës

Bombardimet e Ruisë ndaj Ukrainës kanë ngritur në këmbë Evropën, ku futbollit nuk ngelet mënjane. Shumë lojtarë kanë reaguar ndaj kësaj situatë, ku kanë mbizotëruar ata ukrainas, të cilët mbrojnë vendin e tyre. Por unik është fakti që një lojtar rus po del kundër luftës që shteti i tij nisi. Bëhet fjalë për sulmuesin e Dinamos së Moskës, Fedor Smolov. 32-vjeçari ka bërë një postim në "Instagramin", ku thotë se është kundër luftës. Smolov është i pari futbollist rus që ka folur hapur kundër kësaj lufte.

Lukaku i gatshëm të rikthehet në Inter

Sulmuesi Romelu Lukaku mund të rikthehet tek Interi gjatë kësaj vere. "Gazzetta dello Sport" ka shkruar se belgu ka kërkuar largimin nga Chelsea, ekip të cilit iu bashkua në fillim të këtij sezoni. Mësohet se Lukaku nuk është aspak i kënaqur te londinezët dhe për këtë arsye po synon kthimin në Serinë A. Madje ai është i gatshëm të pranojë edhe pagë më të ulët vetëm t'i bashkohet kampionit në fuqi të Italisë. Lukaku verën e shkuar iu bashkua Chelseas për një shumë rekorde prej 115 milionë eurosh, por nuk ka arritur të ambientohet në "Stamford Bridge". 28-vjeçari ka vetëm dhjetë gola në 28 ndeshje, kurse me Chelsean ka kontratë deri në vitin 2026. Para se t'i bashkohet Chelseas, belgu luajti për dy sezone tek Interi.

Mbappe refuzon sërish rinovimin me PSG-në

Kylian Mbappe sa duket e ka ndarë mendjen, edhe pse PSG-ja nuk po heq dorë për ta bindur që ta rinovojë kontratën. Refuzimi i fundit mund t'i ketë vënë ulën, pasi kampioni i botës nuk ka pranuar një super ofertë të bërë nga ana e drejtuesve të PSG-së. Sulmuesi ka refuzuar 90 milionë euro bruto dhe premtimin se do të ketë një projekt fitues, sigurisht në arenën evropiane. Për shërbimet e Mbappes favorit shikohet Real Madridi, që më parë tentoi ta blinte sulmuesin te PSG-ja, por 160 milionë eurot u refuzuan.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Nr.06/____/2022

Datë 24/02/2022

REPUBLICAN
ACCEPTED ON
PROJLIGJEN
24.02.2022
No. 06/57

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-92 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme, përkatësisht nëni 13 i këtij ligji, komunat duhet që ta publikojnë listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim.

Prandaj, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – Sektori i pronës bazuar në këto dispozita, paraqet listën e pronave të paluajtshme për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër.

Lista e pronave

Nr	Nr parcelës	Sipërfaqja /m2	Zona Kadastrale	Klasa/Kultura	Pronësia
1	223-664	73422	Dragobil	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
2	223-525	10748	Dragobil	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
3	408-1	62628	Dragobil	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
4	408-2	20000	Dragobil	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
5	299-0	45846	Dragobil	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
6	304-0	20861	Dragobil	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
7	641-6	1993	Malishevë	Mal kl 4	Komuna e Malishevës
8	641-7	1000	Malishevë	Mal kl 4	Komuna e Malishevës
9	833-2	100000	Bubavec	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
10	833-4	65081	Bubavec	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
11	1692-1	5147	Banjë	Kullosë kl 2	Komuna e Malishevës
12	162-0	34856	Carrallukë	Kullosë kl 4	Komuna e Malishevës
13	555	40782	Bellanicë	Kullosë kl 6	Komuna e Malishevës
14	13-0	14409	Tërpezë	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
15	2881-2	69898	Llashkadrenoc	Arë kl 5	Komuna e Malishevës
16	919-0	48760	Llashkadrenoc	Arë kl 5	Komuna e Malishevës
17	2868-2	25409	Llashkadrenoc	Arë kl 5	Komuna e Malishevës
18	936-0	74056	Llashkadrenoc	Arë kl 5	Komuna e Malishevës
19	941-0	23372	Llashkadrenoc	Arë kl 5	Komuna e Malishevës
20	115-0	13025	Llashkadrenoc	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
21	2388-0	12132	Llashkadrenoc	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
22	86-0	59363	Pagarushë	Kullosë kl 4	Komuna e Malishevës
23	394-0	28535	Vermicë	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
24	231-0	53624	Vermicë	Mal kl 4	Komuna e Malishevës
25	293-0	35432	Damanek	Kullosë kl 4	Komuna e Malishevës
26	186-0	13924	Guriq	Jo pjellore	Komuna e Malishevës
27	187-0	138838	Guriq	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
28	249	53036	Guriq	Kullosë kl 6	Komuna e Malishevës
29	246	59490	Guriq	Jo Pjellore	Komuna e Malishevës
30	466	118782	Guriq	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
31	1898-0	11670	Banjë	Mal kl 5	Komuna e Malishevës
32	178-0	27345	Carrallukë	Mal i kl 3	Komuna e Malishevës
33	325-0	7011	Gulluboc	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
34	83-0	11701	Pllaqicë	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
35	84-0	18326	Pllaqicë	Mal kl 3	Komuna e Malishevës
36	85-0	19002	Pllaqicë	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
37	429-0	22307	Marali	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
38	1122-0	11119	Marali	Kullosë kl 4	Komuna e Malishevës
39	1263-0	95351	Marali	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
40	1337-0	82139	Marali	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
41	1504-0	17886	Marali	Kullosë kl 4	Komuna e Malishevës
42	296-0	45696	Shkarashnik	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
43	297-1	48477	Shkarashnik	Kullosë kl 3	Komuna e Malishevës
44	1562-0	34939	Kijevë	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
45	214-0	22937	Lladroc	Mal kl 3	Komuna e Malishevës
46	204-0	11780	Lladroc	Mal kl 3	Komuna e Malishevës
47	1015-0	2393033	Lladroc	Mal kl 1	Komuna e Malishevës
48	303-0	279291	Shkozë	Kullosë kl 5	Komuna e Malishevës
49	317-0	6776	Lubizhdë	Kullosë kl 4	Komuna e Malishevës
50	342-0	18869	Lubizhdë	Kullosë kl 4	Komuna e Malishevës

Destinimi

- Pronat e publikuara do të shfrytëzohen për veprimtari të ndryshme bujqësore, prodhuese, rekreacion, si dhe veprimtari tjera varësisht prej interesit të komunës e po ashtu edhe prej kërkesave.

Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për secilin pronë brenda kësaj liste, do të zhvillohen sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-92 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme dhe Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës.

Drejtori – Bashkim Krasniqi

Adresa: Rr. "Skenderbeu" P.nr
24000 Malishevë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Qëllimi

- Rritja e vlerës së pronës komunale, zhvillimi ekonomik dhe rritja e të hyrave vetanake.

Adresa: Rr. "Skenderbeu" P.nr
24000 Malishevë



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel.+383(0)390/321 588
+383(0)390/324 034
+383(0)46 19 55 55
www.cabrati.com
e-mail.info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nën 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212), nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.7/2017, dhe Vendimin Nr.29/202 me Nr. Protokollit 316 i datës 24.02.2022, në përputhje edhe me Organogram dhe Rregulloren "Për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Përgjegjësit në Punë", Nenit 5 të "Rregullores Për Pagat" si dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrje Publike në fuqi, nenit 25 të Statutit të K.R.M. "Çabrati" Sh.A, Gjakovë, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 25.02.2022, vendosi të shpallë:

KONKURS

Pozita: ASISTENT/E ADMINISTRATIV NË OPERATIVË
Numri: 1 /një/
Kohëzgjatja: Kohë të caktuar
I përgjigjet: Menaxherit të Operativës.
Vendi: Gjakovë.

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Pranon shkresat hyrëse, vendimet e brendshme që i dërgohen Njesisë Operative dhe i evidenton në librin e protokollit dhe e përcjellë atë personave që iu dedikohet;
- E siguron dhe e furnizon materialin e nevojshëm të zyrës;
- Kryen punët administrative dhe teknike për nevojat e Menaxherit dhe stafit në administratë;
- I thërret takimet punuese në bazë të urdhëresës së Menaxherit të Operativës;
- Kryen punët e nevojshme me kompjuter, telefon dhe E-mail;
- Pranon ankesat dhe vërejtjet e punëtorëve, i regjistron ato dhe i shpërmdanë të udhëheqësi i njesisë përkatëse;
- Kujdeset për rregull dhe pastërti në zyrën e tij/saj;
- Përgjigjet për kryerjen e rregullt dhe me kohë të punëve dhe detyrave;
- Përbush detyra tjera nga fusha e tij/saj e përgjegjësisë sipas kërkesave të Menaxherit të Operativës.

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Kushtet e përgjithshme:

- Të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë pune;

Kushtet e veçanta:

- Njohja e punës me kompjuter,
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Dëshmia se e njeh punën me kompjuter,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

Konkursi është i hapur **15** (pesëmbëdhjetë) ditë, nga data **25.02.2022** deri me datën **11.03.2022**, në orën **16:00**.

Kërkesa me dokumentacionin e kërkuar, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek menaxheri i Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së testit dhe intervistës.

PROTESTË!

**Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe
populli!
Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!**



"Hero në luftë, Hero në paqe" – 1



"Drenica para gjyqit" – 2



"UÇK-ja para gjyqit" – 3



"Na e ban hallall, Kosove" – 4



"Edhe malet janë UÇK - 5



"Murtaja e Kuqe-7 dramë, 6

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Magma. SH.P.K. me seli në Prishtinë me nrb: 81071136 deklaron zvogëlimin e kapitalit nga njëqind mijë (100.000) Euro në dhjetë mijë (10.000) euro.

► Antigona Pjetraj Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Liridon Doqaj Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Atifete Shala Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Marina Shtufi shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U. "At Gjergj Fishta" në Bishtazhin nga kl. I, V dhe VI-IX.

► Bajram Idriz Juniku Gjakovë shpall të pavlefshme certifikatën për frizer lëshuar nga Q.A. Profesionale Gjakovë.

► Albina Mulliqi Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Jehona Sadiki shpall të pavlefshme Licencën e Punës të Infermierisë së Përgjithshme të lëshuar nga Oda e Infermierëve Prishtinë të lëshuar më 26.02.2019 me nr: KO-286684/A-05-20.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues